



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2331/12 Prot.

Tiranë, më 07.10 2024

V E N D I M

Nr. 154 Datë 07.10 2024

PËR

RIHAPJEN E KONKURSIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME,
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FSHR me nr. 2331/10 prot., datë 03.10.2024, "Përcjellje e Vendimeve të Komisionit ad-hoc dhe kërkesë për rihapjen e konkursit" Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I SHKENCAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE

1.1. Lënda" : "Patologji Specifike",

- Moduli : "Reumatologji", (Bachelor)

1(një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Lektor" për Modulin: "Reumatologji", (Bachelor), në Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

- Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor".
 - (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.

3. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
4. Të ketë veprimtari kërkimore–shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
5. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
6. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.
8. Dëshmi penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Mjekësisë me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Të ketë mbaruar specializimin në fushën e Reumatologjisë.
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
4. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
5. Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e mjekësisë.

I. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

II. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.

- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

III. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.
- IV. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- V. Deri në datën 15.10.2024, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 17.10.2024 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë pune.
- VI. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- VII. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 22.10.2024, për miratim në Rektorat.
- VIII. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

